

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RININË”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon mbrojtje të veçantë për fëmijët e të rinjtë. Në këtë kuadër, ky projektligj kontribuon në realizimin e këtij parashikimi dhe realizimin e objektivave socialë.

Projektligji synon plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues që ndikon tek të rinjtë si edhe rritjen e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

Programi politik i Këshillit të Ministrave parashikon zhvillimin e politikave rinore më qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të të rinjve përmes disa aktiviteteve. Në këtë kuadër, ky projektligj i shërben përmirësimit të legjislacionit, rritjes së aktivizimit dhe pjesëmarrjes të të rinjve dhe vendosjes së standardeve për infrastrukturën në shërbim të të rinjve, duke prezantuar standardin e hapësirave rinore të sigurta.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet përcaktimi i rolit dhe i përgjegjësive të institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve, duke propozuar edhe ngritjen e strukturave të reja në nivel bashkie, të dedikuara për adresimin e çështjeve të të rinjve. Në kuadër të trajtimit të të gjithë aktorëve publikë e jopublikë, si aktorë me rol shumë të rëndësishëm për adresimin e çështjeve të të rinjve projektligji sjell konceptin e rrjetit rinor, pjesë e të cilit janë jo vetëm institucionet e organizatat, por edhe të rinjtë individë. Bashkëpunimi i tyre është projektuar të realizohet nëpërmjet ndërveprimit aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, kuadrin ligjor në fuqi që adreson aspekte të caktuara të mbrojtjes, përfshirjes dhe fuqizimit të të rinjve dhe mundëson ushtrimin efektiv të përgjegjësisë së strukturave përgjegjëse.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj ka përparësi në drejtimet e mëposhtme:

- Përfaqëson një akt ligjor të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve.
- Prezanton mekanizmat e fuqizimit të të rinjve dhe të realizimit të pjesëmarrjes së tyre në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, duke rritur pjesëmarrjen e të rinjve.
- Përcakton veprimtaritë të cilat nxisin aktivizimin e të rinjve dhe mbështeten nga shteti.
- Prezanton konceptin e hapësirave rinore të sigurta që është në fakt standardi që duhet përmbushur në hapësirat ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që i përshtaten nevojave të tyre të shumëllojshme, marrin pjesë në procese vendimmarrëse dhe shprehin mendimet e tyre.
Hapësirat rinore të sigurta përfshijnë hapësirat qytetare që i japin mundësi të rinjve të angazhohen në çështjet e qeverisjes, hapësirat publike që i japin mundësi të rinjve të marrin pjesë në veprimtari sportive, kulturore e argëtuese në komunitet, hapësirat digjitale që i ndihmojnë të rinjtë të ndërveprojnë virtualisht me të rinj të tjerë brenda e jashtë vendit, si dhe hapësira fizike të projektuara dhe të planifikuara për të plotësuar nevojat e shumëllojshme të të rinjve në përgjithësi, e sidomos të atyre nga grupet vulnerabël ose të marginalizuar. Ky koncept ka përafuar konceptin e Këshillit të Evropës për hapësirat rinore.
- Prezanton dhe rregullon konceptet e “edukimit joformal për të rinjtë” dhe rëndësinë e tij, konceptin e “punës rinore” dhe “punonjësit rinorë” me qëllim vendosjen e disa kriterëve bazë për profesionistët që do të punojnë me të rinjtë.
- Përcakton rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, duke ofruar një listë të detajuar të detyrave të institucioneve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes e të fuqizimit të të rinjve. Lista e përgjegjësive parashikon angazhime, përgjegjësi e detyra konkrete për këto institucione në mbështetje të mirëqenies e zhvillimit të potencialit të të rinjve.
- Mundëson krijimin e bazës ligjore për dy struktura konsultative, Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe këshillit vendor të rinisë, që do të operojnë në nivel kombëtar dhe vendor dhe do të marrin pjesë në hartimin e zhvillimin e politikave dhe veprimtarive në fushën e rinisë.
- Prezanton institucionin përgjegjës për rininë, që do të ketë një rol të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave që merren me të rinjtë, në nivel qendror dhe vendor, publike e private.
- Rregullon kriteret e organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, si dhe organizatës kombëtare përfaqësuese rinore, e cila do të jetë një organizatë mëmë dhe njësi reference për konsultimin e të gjitha politikave, të cilat ndikojnë tek të rinjtë.

Nëpërmjet kritereve të propozuara synohet rritja e aktivizimit rinor dhe rritja e bashkëveprimit ndërmjet organizatave rinore e organizatave për të rinjtë, me qëllim bashkimin e njohurive e të potencialeve si dhe krijimin e sinergjive për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Këto subjekte do të mbështeten me financime nga buxheti i shtetit dhe buxhetet vendore. Projektligji parashikon edhe krijimin e personave juridikë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat më pas mund të marrin pjesë në thirrjet e hapura për projektet rinore dhe aplikojnë për mbështetje nga projektet kombëtare e ndërkombëtare.

- Parashikon burimet e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim krahas planifikimeve e parashikimeve të buxhetit të shtetit. Njëkohësisht parashikon edhe burime të tjera të ligjshme financimi, si të ardhurat e gjeneruara nga veprimtaria e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj.
- Në kuadër të financimit, projektligji parashikon financimin dhe bashkëfinancimin dhe parashikon mënyrat e financimit dhe zërat konkretë të financimit.
- Rregullon bazën e të dhënave për rininë, përmbajtjen e qëllimin e saj për të siguruar informacion të përditësuar për situatën e nevojat e të rinjve, në mbështetje edhe të planifikimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të ndikimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor. Në këtë drejtim, baza e të dhënave përmban jo vetëm informacion për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, organizatat e tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e mbrojtjes të fuqizimit të të rinjve, por edhe informacion për politikat kombëtare e ndërkombëtare, mundësitë e financimit të projekteve dhe studime, analiza e informacione të tjera me interes për të rinjtë.

Efekti i pritshëm i këtij projektligji është përmirësimi i situatës të të rinjve në të gjithë vendin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për rininë” përbëhet, gjithsej, nga 20 nene.

Në nenin 1 parashikohet se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë e të të rinjve shqiptarë në diasporë dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës të të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Ministria përgjegjëse për rininë luan rol kryesor në zhvillimin, koordinimin dhe rishikimin e politikave rinore dhe, nisur nga rëndësia e përmirësimit të legjislacionit në këtë fushë dhe nga nevojat e identifikuar nga konsultimet me organizatat rinore, është e vlerësuar si e domosdoshme përgatitja dhe miratimi i një ligji për rininë. Kjo ndërhyrje në kuadrin ligjor nga ana e qeverisë shqiptare do të sjellë fuqizimin e sektorit të rinisë dhe krijimit të kushteve për adresimin e nevojave dhe interesave të të rinjve.

Projektligji synon mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; përcaktimin e funksioneve dhe të kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike, si dhe rolit të organizatave, që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë; si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë. Projektligji do të përmirësojë zhvillimin dhe zbatimin e politikës kombëtare për rininë.

Në nenin 2 jepen përkufizimet për disa terma të përdorur, duke propozuar dhe përkufizimin për termin “i ri/e re”. Ky term na lejon të përkufizojmë targetgrupin që do të jetë përfituesi kryesor i këtij ligji si dhe na mundëson të realizojmë mbledhjen, analizimin, publikimin dhe përditësimin e të dhënave periodike, në lidhje me situatën e të rinjve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë projektligj, propozohen të paraqiten edhe terma të rinj, të cilët sigurojnë harmonizimin e politikave rinore me politikat e zbatuara nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Në projektligj trajtohen termat, në kuptim të këtij ligji:

- a) “Dialog i strukturuar”, dialogu i hapur, transparent, afatgjatë, i vazhdueshëm dhe sistematik mes të rinjve e organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, si dhe institucioneve në nivel qendror e vendor, që mbulojnë çështje të lidhura me të rinjtë.
- b) “Edukimi joformal për të rinjtë”, çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënies nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës.
- c) “Hapësira rinore e sigurt”, standardi që duhet përmbushur në hapësirat ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që i përshtaten nevojave të tyre të

shumëllojshme, marrin pjesë në procese vendimmarrëse dhe shprehin mendimet e tyre. Hapësirat rinore të sigurta përfshijnë hapësirat qytetare që i japin mundësi të rinjve të angazhohen në çështjet e qeverisjes dhe të marrin pjesë në veprimtari sportive, kulturore e argëtuese në komunitet, hapësirat digjitale që i ndihmojnë të rinjtë të ndërveprojnë virtualisht me të rinj të tjerë brenda e jashtë vendit dhe hapësira fizike të projektuara dhe të planifikuara për të plotësuar nevojat e shumëllojshme të të rinjve në përgjithësi e sidomos të atyre nga grupet vulnerabël ose të marginalizuara.

- ç) “Infrastrukturë rinore”, një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtese e projektuar dhe planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore.
- d) “Politikë rinore”, veprimtaria e qëllimshme dhe e qëndrueshme gjithëpërfshirëse e ndërmarrë nga ana e pushtetit qendror e vendor, organizatave rinore dhe shoqërive, që synojnë krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore, në nivel vendor dhe kombëtar, nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.
- dh) “Punonjës rinor”, personi i përgatitur, që ka kryer trajnime të veçanta dhe/ose ka eksperiencë profesionale për të punuar me të rinjtë dhe zbatuar veprimtari rinore.
- e) “Subjekt i politikave rinore”, çdo organ, institucion dhe strukturë, në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtron përgjegjësi që prekin të rinjtë dhe harton politika rinore, si dhe aktorë të tjerë që marrin pjesë në procesin e hartimit e zbatimit të politikave rinore.
- ë) “Subsidiaritet”, parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë të rinjve.
- f) “Të rinj”, personat që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç. Përcaktimi i këtij segmenti moshor është realizuar duke marrë parasysh studimet e deritanishme nga Eurostat, ku në Bashkimin Evropian (BE) “të rinj” janë përkufizuar individë të moshës 15-29 vjeç. I jemi referuar, gjithashtu, rezultateve të kërkimeve të kryera përgjatë procesit konsultativ, në kuadër të hartimit të këtij projektligji, si anketimi *on-line* përmes mekanizmit të UNICEF, i quajtur “U Report”, apo dhe intervistave me të rinj në mbarë Shqipërinë. Së fundi, po ashtu dhe studimet e INSTAT-it përcaktojnë si “të rinj” individët nga mosha 15 – 29 vjeç.
- g) “Organizatrat rinore”, persona juridikë jofitimprurës, që kanë për qëllim përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse.
- gj) “Organizatrat për të rinjtë”, persona juridikë jofitimprurës, që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë për qëllim edhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave të të rinjve.

Në nenin 3 të projektligjit parashtrohen parimet kryesore të mbështetjes dhe të fuqizimit të të rinjve, duke parashikuar këto parime:

- a) Respektimin e të drejtave të të rinjve dhe mbështetjes me qëllim fuqizimin e

- tyre;
- b) Barazinë në të drejta e mundësi;
- c) Mosdiskriminimin;
- ç) Garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes;
- d) Lirinë e organizimit, iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;
- dh) Subsidiaritetin.

Në nenin 4 propozohet të prezantohet koncepti i rrjetit rinor. Rrjeti rinor përfshin të gjithë strukturën e rinisë në Republikën e Shqipërisë, e cila përbëhet nga institucionet dhe organizmat, në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësi në fushën e të drejtave e të mbrojtjes të të rinjve, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që veprojnë në nivel qendror dhe vendor. Ky rrjet ka rol konceptual dhe jo institucional, duke siguruar kështu bashkëveprimin në sinergji të të gjitha institucioneve dhe organizmave në përbërje të tij. Funkzioni i secilit institucion apo organizëm përcaktohet nga ky projektligj, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe legjislacioni tjetër në fuqi, që normon çështje të caktuara që lidhen me të rinjtë.

Në nenin 5 të projektligjit parashikohen kompetencat e ministrisë përgjegjëse për rininë, e cila do të ketë rolin kryesor në hartimin, koordinimin, menaxhimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së këtij ligji. Për aktivitete në të cilat ministria përgjegjëse për rininë do të jetë partner kryesor, monitorimi do të kryhet direkt nga strukturat përkatëse të saj. Për aktivitetet në të cilat kjo ministri është partnere mbështetëse, monitorimi do të bëhet në mënyrë indirekte përmes vizitave në terren, mbledhjes të të dhënave nga partnerët dhe raportimeve përkatëse.

Oërr ministrinë përgjegjëse për rininë propozohet të ketë kompetencat e mëposhtme:

- a) Harton dhe propozon politikat dhe veprimtaritë për rininë;
- b) Planifikon buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë;
- c) Harton dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve;
- ç) Monitoron zbatimin e politikave si dhe veprimtarive rinore;
- d) Miraton standardet për ndërtimin e hapësirave të sigurtat dhe të aksesueshme për të rinjtë;
- dh) Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në nivelet dhe organizmat ndërkombëtarë për çështjet e rinisë;
- e) Përmbush detyrimet e anëtarësimit dhe bashkërendon pjesëmarrjen në programe e projekte ndërkombëtare në fushën e rinisë;
- ë) Bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë.

Në nenin 6 parashikohen kompetencat e institucioneve të tjera qendrore, që brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

- a) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat e të rinjve, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe të programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të të rinjve;
- b) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve;
- c) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

Në nenin 7 parashikohen kompetencat e njësisve të vetëqeverisjes vendore, të cilat do të kenë kryesisht ndikime të drejtpërdrejta tek të rinjtë. Në përputhje me funksionet e tyre dhe në harmoni me ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, këto institucione do të hartojnë dhe do të zbatojnë politikat në fushën e rinisë.

Në veçanti, për bashkitë propozohet që, në përputhje me misionin e tyre, të jenë përgjegjëse për:

- a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojë zbatimin e tyre;
- b) krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendorë në fushën e mbrojtjes dhe fuqizimit të të rinjve;
- ç) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- dh) financimin për krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t’u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 8 të projektligjit parashikohen forma dhe funksionet e institucionit përgjegjës për rininë.

Deri në miratimin e këtij projektligji, institucioni përgjegjës në nivel qendror për zbatimin e politikave dhe të programeve të hartuara nga ministria përgjegjëse për politikën dhe çështjet rinore është Shërbimi Kombëtar për Rininë, i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të vendimit nr.377, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave. Sipas ndryshimeve të parashikuara në këtë projektligj, sa i takon formës dhe funksioneve për këtë institucion qendror, Shërbimi Kombëtar për Rininë do të riorganizohet.

Institucioni përgjegjës për rininë do të jetë person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë, që financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Institucioni përgjegjës për rininë propozohet të kryejë këto funksione:

- a) Zbaton politikën dhe programet për të rinjtë;
- b) Organizon, administron, financon, koordinon dhe monitoron programet dhe projektet rinore;
- c) Bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase e të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;
- ç) Mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor;
- d) Krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë;
- dh) Siguron financime, nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i trashëgon në vitet pasardhëse buxhetore.

Veçanërisht, këtij institucion qendror ndër të tjera i shtohet një funksion me rëndësi të veçantë, siç është financimi i programeve dhe i projekteve rinore, të parashikuara në shkronjën “b”, të këtij neni.

Mënyra e krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë propozohet të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 9 propozohet ngritja e Këshillit Kombëtar të Rinisë. Projektligji mundëson krijimin e bazës ligjore për këtë strukturë konsultative, që do të operojë në nivel kombëtar. Ky Këshill do të marrë pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave e veprimtarive në fushën e rinisë.

Këshilli Kombëtar i Rinisë propozohet të jetë organ këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë propozohet të kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe përbëhet nga 14

anëtarë.

Propozohet që përbërja, mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve, organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Rinisë të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 10 propozohet ngritja e këshillit vendor të rinisë. Projektligji mundëson krijimin e bazës ligjore për këtë strukturë konsultative, që do të operojë në nivel vendor.

Këshilli vendor i rinisë propozohet të jetë organ këshillimor, që krijohet dhe funksionon pranë kryetarit të bashkisë, me qëllim konsultimin e planeve vendore, monitorimin e planeve e politikave rinore në nivel vendor dhe propozimin e nismave që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku ata veprojnë.

Këshilli vendor i rinisë propozohet të kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 anëtarë, me përfaqësi të barabartë nga strukturat rinore, publike dhe jopublike, që veprojnë në nivel vendor.

Ky këshill do të kryesohet nga kryetari i bashkisë, duke ndjekur të njëjtën linjë, sikurse edhe struktura e Këshillit Kombëtar të Rinisë. Numri i anëtarësisë nuk është përcaktuar përfundimisht, pasi varion sipas madhësisë së çdo strukture të vetëqeverisjes vendore. Përcaktimi i vetëm është që ky numër të jetë tek, për të mos hasur pengesa në votim.

Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit rinor vendor propozohet të miratohen me vendim të këshillit bashkiak referuar kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Në nenin 11 propozohet forma dhe kriteret për organizatat rinore. Organizatat rinore propozohet të jenë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen, riorganizohen apo transformohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit për organizatat jofitimprurëse. Propozohet që një organizatë të konsiderohet si organizatë rinore në kuptimin e këtij projektligji, nëse ka në statut, si objekt të veprimtarisë së saj, aktivitete dhe veprimtari rinore dhe ku të paktën 70 % e anëtarëve të saj janë të rinj.

Përcaktimi i kushtit, ku të paktën 70% e anëtarëve të organizatave rinore të jenë të rinj është realizuar me qëllim nxitjen e të rinjve për t'u bërë pjesë e këtyre subjekteve, për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të fituar eksperiencë në fushën e edukimit joformal. Gjithashtu, nuk diskriminohen as aktivistët e hershëm, pjesë e këtyre subjekteve, të cilët mund të vijojnë veprimtarinë në to, edhe pasi tejkalojnë segmentin moshor, që përcakton targetin "i ri/e re", me qëllim për të përfituar nga eksperiencia dhe njohuritë e tyre në fushën e rinisë.

Merren në konsideratë subjektet juridike me anëtarësi, bazuar në parimin e kolektivizmit, që nxit bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve duke vendosur interesin e

përgjithshëm mbi interesin vetjak, gjithashtu, duke ndihmuar njëri-tjetrin, për të kryer bashkërisht çdo punë dhe veprimtari. Kështu, të rinjtë do të grupohen ose do t'i atashohen organizatave rinore, për të vënë në zbatim idetë e tyre.

Zhvillimi i organizatave rinore parashikohet të inkurajohet dhe të mbështetet nga programet e projektet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Regjistrimi si organizatë rinore në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18 të këtij projektligji, bëhet me kërkesë të organizatës.

Propozohet që organizatat rinore të mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror, nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Në nenin 12 propozohet forma dhe kriteret për organizatat për të rinjtë. Ato janë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen, organizohen apo transformohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së organizatave për të rinjtë fokusohet tek të rinjtë dhe për një periudhë prej të paktën 3 vitesh këto organizata duhet të kenë zbatuar në mënyrë të vazhduar projekte e programe me impakt tek të rinjtë.

Propozohet që organizatat për të rinjtë të mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror, nëpërmjet fondit të dedikuar për rininë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Regjistrimi si organizatë për të rinjtë në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18 të këtij ligji, bëhet me kërkesë të organizatës.

Në nenin 13 propozohet forma dhe kriteret për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore propozohet të jetë një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e miratuar përpara kërkesës për regjistrim, nga ministri përgjegjës për rininë. Nëse ministri përgjegjës nuk e miraton paraprakisht statutin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit, statuti propozohet të konsiderohet i miratuar në heshtje.

Është propozuar që të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore ta kenë jo më pak se 30 organizata rinore dhe/ose për të rinjtë me të paktën 1 000 anëtarë, që ushtrojnë veprimtarinë në një territor prej të paktën 70% të bashkive të vendit. Organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, themeluese dhe anëtare, pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate të rregulluara në statutin e saj.

Sipas këtyre kriterëve të parashikuara në projektligj, argumentojmë se në këtë organizatë do të aderojnë organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe kjo strukturë mëmë do të luajë një rol aktiv në zhvillimin e politikës publike të të rinjve.

Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është strukturë operationale në të gjithë vendin, e cila do të luajë rol kryesor në koordinimin e veprimtarisë mes organizatave jofitimprurëse të sektorit të rinisë. Ky subjekt do të kontribuojë në zhvillimin dhe implementimin e politikave në fushën e rinisë, do të monitorojë punën e institucioneve, në nivel qendror e vendor, si dhe punën e grupeve të tjera të interesit. Gjithashtu, kjo organizatë do të përfaqësojë Shqipërinë në strukturat dhe veprimtaritë në nivel ndërkombëtar.

Është propozuar që ministria përgjegjëse për rininë të njohë vetëm një Organizatë Kombëtare Përfaqësuese Rinore. Kjo do të jetë një strukturë mëmë, ku mund të anëtarësohen të gjitha organizatat e tjera rinore dhe organizatat për të rinjtë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me rregullat dhe statutin e miratuar. Roli kryesor i organizatës kombëtare do të jetë përfaqësimi dhe advokimi kombëtar e ndërkombëtar, ofrimi i mbështetjes dhe rritja e kapaciteteve për organizatat e tjera rinore dhe organizatat për të rinjtë. Njohja e saj si Organizatë Kombëtare Përfaqësuese Rinore është propozuar të bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë, në bazë të kërkesës së vetë organizatës dhe është e vlefshme për 3 vite kalendarike nga dita e njohjes, përveçse kur organizata nuk plotëson kriteret në mënyrë të vazhduar përgjatë periudhës 3-vjeçare, nuk i shërben misionit të saj ose keqpërdor pozitën.

Në rast se në të njëjtën kohë konkurron më shumë se një organizatë, që plotëson kriteret për të marrë statusin e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, përparësi do t'i jepet organizatës që ka më shumë anëtarë. Në rast se organizatat konkurruese kanë të njëjtin numër anëtarësh, përzgjedhja do të bëhet me short.

Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore propozohet të financohet nga kontributi i anëtarëve, nga organet e pushtetit qendror ose vendor, mbi bazë projektesh, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 14 prezanton një koncept për “punën rinore” dhe “punonjësia rinor” duke propozuar që punë rinore të konsiderohet çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.

Puna rinore realizohet nëpërmjet angazhimit dhe aktivizimit të të rinjve në veprimtari që reflektojnë nevojat, interesat, idetë dhe eksperiencat e tyre. Nëpërmjet këtij procesi të të nxënies joformal, të rinjtë fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, që nevojiten për zhvillimin personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive.

Gjithashtu, propozohet të rregullohet pozita e punonjësia rinor që në këtë projektligj është parashikuar të jetë personi që ofron shërbime këshillimi, informimi, mbështetjeje dhe udhëzime për të rinjtë, duke i ndihmuar ata të përdorin maksimalisht aftësitë dhe mundësitë e tyre në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm personal,

emocional, social dhe ekonomik. Puna e punonjësve rinorë propozohet të përfshijë çdo veprimtari në mbështetje të rinjve, duke përfshirë planifikimin dhe menaxhimin e veprimtarive komunitare, edukative, informuese dhe këshilluese. Punonjësit rinorë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë organizatave rinore dhe për të rinjtë, si dhe pranë strukturave të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Nuk ka një përcaktim të saktë të kritereve lidhur me arsimimin, punësimin apo eksperiencën, që duhet të ketë një individ për t'u quajtur punonjës rinor, pasi "punonjësi rinor" mund të njihet si profesion, nëpërmjet akteve të posaçme nënligjore për profesionet e rregulluara.

Miratimi i këtij projektligji propozon që si punonjës rinorë të merren në konsideratë individët që kryejnë punë rinore. Kështu, mund të jenë punonjësit në strukturat administrative rinore në rang qendror e vendor, përfaqësues të organizatave rinore dhe organizatave për të rinj, trajnues në programet dhe projektet rinore etj.

Në nenin 15 për realizimin e politikave, të programeve dhe të projekteve rinore propozohen burimet e financimit që janë, si më poshtë vijon:

- a) Fondet grant nga buxheti i shtetit, i dedikuar për rininë;
- b) Buxhetet vendore;
- c) Të ardhura të gjeneruara nga organizatat rinore;
- ç) Donacionet;
- d) Sponsorizimet;
- dh) Burime të tjera të ligjshme.

Fondi grant nga buxheti i shtetit, i dedikuar për rininë, propozohet të përcaktohet në buxhetin vjetor të shtetit për ministrinë përgjegjëse për rininë, ndërsa përdorimi i fondeve publike nga buxheti i shtetit për institucionet dhe organizatat rinore dhe për të rinjtë të bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Kriteret dhe procedurat për përdorimin e fondit grant të dedikuar për rininë nga buxheti i shtetit për politikën, programet dhe projektet rinore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 16 propozohen veprimtaritë, mënyrat dhe zërat e financimit. Financimi dhe bashkëfinancimi i politikave, programeve, projekteve e veprimtarive rinore propozohet të planifikohet dhe të realizohet nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, lidhur me:

- a) financimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore;
- b) financimin e projekteve të organizatave rinore e për të rinjtë;
- c) bashkëfinancimin për pjesëmarrje në programe ndërkombëtare;

Gjithashtu, propozohet që fondi i projekteve për zhvillimin dhe financimin e objekteve e të infrastrukturës rinore shpërndahet mbi bazën e projekteve që paraqiten nga subjektet sipas këtij ligji.

Projektet e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore paraqiten dhe miratohen mbi bazën e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 17 propozohet të përcaktohet termi i infrastrukturës rinore. Infrastruktura rinore propozohet të përbëhet nga pasuritë e paluajtshme, pronë publike, të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

Infrastruktura publike rinore propozohet të jetë pasuri e paluajtshme në pronësi të pushtetit qendror ose vendor, sipas juridiksionit të vendndodhjes territoriale të tyre, të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

Propozohet që përgjegjës për ndërtimin, rindërtimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shërbimet, si dhe krijimin e kushteve për funksionimin normal të tyre të jenë pronarët apo administratorët e infrastrukturës.

Infrastruktura rinore ndërtohet, rindërtohet, përshtatet dhe mirëmbahet në funksion dhe për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive për rininë, në përputhje me standardin e hapësirave rinore të sigurta, përcaktuar në nenin 3, të këtij projektligji.

Ndërtimi i infrastrukturës rinore propozohet të bëhet në përputhje me standardet dhe kushtet teknike të miratuara nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

Pjesë e infrastrukturës rinore propozohet të jenë dhe pasuritë e luajtshme të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

Në rastin konkret mund të përmendim bibliotekat, pajisjet informatike, pajisjet sportive etj. të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

Pronarët apo administratorët e mjediseve duhet të garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-sanitare, shëndetësore, të aksesueshme për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të infrastrukturës rinore, në përputhje me standardin e hapësirave të sigurta.

Neni 18 propozon krijimin e përmbajtjes së bazës të të dhënave për rininë në vend, si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, të mbikëqyrjes, të administrimit dhe të vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

Baza e të dhënave për rininë propozohet të përmbajë:

- a) të dhënat parësore që kanë të bëjnë me organizata rinore dhe për të rinjtë në vend dhe në diasporë, Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore, politikat rinore kombëtare, vendore dhe evropiane;

- b) të dhënat dytësore që kanë të bëjnë me financimin e projekteve dhe të veprimtarive rinore, studime, analiza, vlerësime, vëzhgime dhe vlerësime të zbatimit të politikave rinore.

Institucioni përgjegjës për rininë administron bazën e të dhënave që ka të bëjë me të rinjtë, përmbajtja e së cilës publikohet në portalin “Për rininë”, dhe realizon ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit, sipas rregullave të koordinimit të përcaktuara nga autoriteti rregullator koordinues.

Në nenin 19 parashikohet të ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 3, 9, pika 3, 15, pika 3, dhe 16, pika 2, të këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET E TJERA QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet ministria përgjegjëse për rininë, institucione të tjera qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me kontributin e përfaqësuesve të ministrive të linjës dhe të Departamentit të Administratës Publike, përfaqësues të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, me mbështetjen dhe asistencën e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA) dhe *Olof Palme International Center*.

Gjatë hartimit të projektligjit janë zhvilluar konsultime publike në 12 qarqet e vendit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Projektligji është publikuar në datën 15.11.2018 në *ëbsite*-in e konsultimit publik dhe nuk ka pasur komente.

Projektligji është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në datën 7.11.2018.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në datën 7.2.2019, e ka dërguar për mendim nëpërmjet sistemit *e-aktet* projektligjin “Për rininë”, në të gjitha ministritë e linjës dhe në Departamentin e Administratës Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon burimet e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim krahas planifikimeve e parashikimeve të buxhetit të shtetit. Njëkohësisht parashikon

edhe burime të tjera të ligjshme financimi si të ardhurat e gjeneruara nga veprimtaria e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj. Në kuadër të financimit, projektligji parashikon financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve, mënyrat e financimit dhe zërat konkretë të financimit. Nëpërmjet kritereve të propozuara synohet rritja e aktivizimit rinor dhe rritja e bashkëveprimit ndërmjet organizatave rinore me qëllim bashkimin e njohurive dhe potencialeve si dhe krijimin e sinergjive për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Këto subjekte do të mbështeten me financime nga buxheti i shtetit dhe buxhetet vendore. Projektligji parashikon edhe krijimin e personave juridikë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat më pas mund të marrin pjesë në thirrjet e hapura për projektet rinore dhe aplikojnë për mbështetje nga projektet kombëtare e ndërkombëtare.

Financimi i politikave, programeve e veprimtarive rinore, si dhe bashkëfinancimi i politikave, programeve, projekteve e veprimtarive rinore planifikohet e realizohet nëpërmjet fondeve grant, me synim përmirësimin e infrastrukturës rinore, financimin për ndërtimin e objekteve për rininë, financimin e veprimtarisë dhe projekteve të organizatave rinore, financimin për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare, financimin e studimeve, vëzhgimeve dhe analizave, e të tjera, ku përfitues të drejtpërdrejtë janë të rinjtë.

Kriteret dhe procedurat për përdorimin e fondit grant të dedikuar për rininë nga buxheti i shtetit për politikën, programet dhe projektet rinore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin dhe financimin e objekteve dhe të infrastrukturës rinore shpërndahet mbi bazën e projekteve që paraqiten nga organizmat e rrjetit rinor, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxhetit. Projektet e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore paraqiten dhe miratohen mbi bazën e procedurave konkurruese të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Miratimi i këtij projektligji nuk mbart kosto të shtuara për buxhetin e shtetit, pasi parashikimet financiare, për tri vitet e para 2019-2021 për fondet me burim financimi nga buxheti i shtetit janë mbajtur brenda tavanëve të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”.

Për fondet e parashikuara “Të pambuluara” janë parashikuar financime nga donatorë të mundshëm OJF ose financime të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe financime të tjera të huaja që të kenë mundësi të investojnë për rininë.

Në 000 lekë

Financimi	Viti 1_ 2019	Viti 2_ 2020	Viti 3_ 2021
Total	868 000	1 066 000	1 250 000
Buxheti i shtetit	468 000	566 000	650 000

Të pambuluara	400 000	500 000	600 000
---------------	---------	---------	---------

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar me financim nga fondi grant i buxhetit të shtetit, i dedikuar për rininë si dhe buxhetet vendore, gjatë periudhës 3-vjeçare, që menjëherë pas miratimit të ligjit, janë fonde që parashikohet të prekin rreth 500-550 mijë të rinj përfitues në të gjithë vendin nga mosha 15 deri 29 vjeç.

Grupet më përfituese janë detajuar, si vijon:

- të rinj të grupmoshës 15-19 vjeç, që aktualisht ndjekin arsimin e mesëm publik dhe privat rreth 150 mijë;
- të rinj të grupmoshës 19-23 vjeç, që kryesisht janë në universitet si dhe shkolla të tjera të larta, rreth 150 mijë studentë që ndjekin tri ciklet e studimeve në IAL-të publike dhe private;
- të rinjtë e grupmoshës 24-29 vjeç, që janë të punësuar apo punëkërkues, rreth 200 mijë të rinj.

Kostot e parashikuara si të pambuluara janë parashikuar si mundësi financimi apo bashkëfinancimi nga donatorë, financim nga biznesi apo projekte të tjera ndërkombëtare.

Miratimi i këtij projektligji do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe të pozitës të të rinjve/rejave, si dhe krijimin e kushteve për adresimin e nevojave të të rinjve/rejave në të gjitha fushat që përbëjnë interes rinor. Ky opsion do të krijojë kushte për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve vetjake dhe shoqërore, si dhe mbështetjen e të rinjve/rejave në organizime dhe aktivizime sociale dhe është opsioni i vetëm që do të mundësojë arritjen e objektivave të politikave ligjërish.

KËSHILLI I MINISTRAVE